

## Materiale ndihmëse për hartimin e Manualit të Maturantit Nr. 2

(Matura Shtetërore 2011)

### Konkurimi sipas parimit Meritë – Preferencë

Për t'u ardhur në ndihmë maturantëve që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në Institucionet e Arsimit të Lartë Publik (IALP) të Republikës së Shqipërisë si dhe në kuadër të këshillimit të karrierës, vëmë në dispozicion të tyre një informacion të plotë për t'u njohur me parimin Meritë – Preferencë, i cili qëndron në thelb të procesit informatik të shpërndarjes së degëve të studimit.

Më poshtë po e shpjegojmë sa më qartësisht këtë parim:

- i. Parimi i meritës përcaktohet sipas pikëve të grumbulluara në bazë të rezultateve të shkollës së mesme, të provimeve të Maturës Shtetërore dhe për programe studimi të caktuara Arte, Sporte, Arkitekturë, etj., edhe në bazë të plotësisimit të kriterëve të veçanta të propozuara nga IALP-të dhe të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH).
- ii. Parimi i preferencës përcaktohet nga vullneti i kandidatëve, i shprehur nëpërmjet preferencës më të lartë të grupit të preferencave fituese, midis 10 ose më pak preferencave të zgjedhur prej tyre.

#### 1. Çfarë duhet të kuptojmë me konceptin Meritë

Maturanti që dëshiron të vazhdojë studimet në IALP duhet të ketë fituar 5 rezultate: Notën Mesatare të 4 ose 5 viteve të studimit në shkollën e mesme, 2 nota të shkallëzuara në provimet e detyruara, Letërsi dhe Matematikë dhe 2 nota të shkallëzuara në dy provimet me zgjedhje. Në bazë të këtyre notave, për secilin maturant llogariten pikët që ai fiton dhe që shërbejnë për të konkurruar për studime në programe të ndryshme studimi në IALP. Formula e thjeshtë dhe më e përdorshme për llogaritjen e pikëve është:

$$[(D1 + D2 + MES)KSH + Z1 \times KZ1 + Z2 \times KZ2] \times 100$$

ku D1, D2, MES, Z1, Z2 janë respektivisht notat e shkallëzuara me dy shifra pas presjes dhjetore të letërsisë, matematikës, mesatares së shkollës, të lëndës së parë dhe të dytë me zgjedhje.

**KSH** – është koeficienti i shkollës. Për secilin lloj shkolle, IALP-të propozojnë koeficientin përkatës në varësi nga drejtimi i shkollës së mesme. E thënë më thjesht Fakultetet për programet e studimit me drejtim natyror, preferojnë maturantët me më shumë prirje në shkencat egzakta dhe për këto shkenca propozojnë koeficientë më të lartë. E gjitha kjo bëhet që Fakultetet të thithin kontigjentet e përgatitura më mirë në drejtimin e kërkuar nga programet e studimit që ofrojnë. Informacionin e plotë për këta koeficientë të propozuar nga IALP-të dhe të miratuara nga MASH, çdo maturant kandidat mund ta gjejë në linkun e mëposhtëm:

[www.mash.gov.al](http://www.mash.gov.al) dhe më pas klikoni tek butoni MATURA SHTETËRORE

**KZ1, KZ2** – janë koeficientët e lëndëve me zgjedhje, që gjithashtu propozohen nga IALP-të mbi bazën e të njëjtit arsyetim. Informacionin e plotë për këta koeficientë të propozuar nga IALP-të dhe të miratuara nga MASH, çdo maturant kandidat mund ta gjejë në linkun e mësipërm:

Formula e përgjithshme ndryshon pak për rastin e shkollave social kulturore dhe profesionale. Në rastet kur maturanti ka mbaruar këto lloj shkollash, marrin pjesë dhe koeficientët **KD1** dhe **KD2**. Këta koeficientë nuk janë gjë tjetër veçse përqindja (pesha) që zënë lënda e letërsisë (D1) dhe e matematikës (D2) në formulë. Informacionin e plotë për këta koeficientë çdo maturant kandidat mund ta gjejë në linkun e mëposhtëm:

[www.mash.gov.al](http://www.mash.gov.al) dhe më pas klikoni tek butoni MATURA SHTETËRORE

Më poshtë japim interpretimin e këtyre koeficientëve:

Për shkollat e mesme profesionale, provimi i detyruar Letërsi zë 15% të peshës, ndërsa provimi i detyruar Matematikë zë 25% të peshës. E kundërta ndodh për shkollat e mesme social kulturore ku Letërsia zë 25% të peshës dhe Matematika 15% të peshës. Në këto raste formula do të jetë:

$$\{[D1(KD1/0.2) + D2(KD2/0.2) + MES]KSH + Z1xKZ1 + Z2xKZ2\} \times 100.$$

Për të gjitha llojet e shkollave të tjera, pesha e secilit provim është 20% dhe për këtë arsye ato nuk shfaqen në formulën e thjeshtë të paraqitur më sipër.

Për rastet kur maturantët kërkojnë të studiojnë në programet e studimit që parashikojnë konkurse si Arkitektura, Edukimi Fizik, Artet, Pedagogji e specializuar, etj., formula e llogaritjes së pikëve merr parasysh edhe rezultatet e konkurseve sipas peshës së tyre.

Për programet e studimit me konkurs, formula llogaritëse është:

$$\frac{PikeMatura}{PikeMaxMatura} \times x\% Matura + \frac{PikeKonkursi}{PikeMaxKonkursi} \times x\% Konkursi$$

Informacion që mund ta gjeni në linkun e paraqitur më sipër. **Tek formula e llogaritjes së pikëve në Excel mund të gjeni shpjegimin për secilin nga elementet që gjenden në formulën e llogaritjes së pikëve.**

Sëfundmi duhet të theksojmë se llogaritja e pikëve për secilin maturant bëhet sipas profilit të shkollës së mesme dhe preferencave të tija për programe të ndryshme studimi.

Kështu secili maturant në përfundim të shkollës së mesme dhe katër provimeve të Maturës Shtetërore ka grumbulluar një sasi pikësh që përbëjnë Meritën e tij.

## 2. Çfarë duhet të kuptojmë me konceptin Preferencë

Duke filluar që nga viti 2007, në dispozicion të maturantëve vihet lista e programeve të studimit që ofrojnë IALP-të. Kjo listë përbëhet 232 programe studimi në vitin 2009 dhe 265 programe studimi në vitin 2010. Të gjitha programet e studimit shpallen në Formularin A2. Me plotësimin e Formularit A2, maturanti shpreh dëshirën për të studiuar në një nga 10 ose më pak programet e studimit të preferuara prej tij, dhe shpallet fitues në preferencën më të lartë të grupit të preferencave ku shpallet fitues (pra arrin pikët e e nevojshme).

Kjo do të thotë që maturanti duhet të jetë shumë i kujdesshëm në plotësimin e preferencave. Çfarë do të thotë të përzgjedhësh dhe të renditësh preferencat?

Një maturant me rezultate shumë të larta, me pikët që grumbullon mund të jetë fitues në të dhjetë preferencat e zgjedhura prej tij, por sistemi atë e shpall fitues në preferencën e parë. Një maturant me rezultate shumë të dobta, nuk shpallet fitues në asnjërën prej preferencave të tij. Nëse maturanti është me rezultate mesatare, shpallja e tij fitues varet nga rezultatet e grupit të maturantëve që kanë kërkuar po ato programe studimi sikurse dhe ai.

**Sikurse duket qartë, faktori kryesor dhe përcaktues është Merita, sasia e pikëve të grumbulluara.**

## 3. Si duhet të plotësohet Formulari A2

Këtë vit Formulari A2 do të shpërndahet pasi maturantët të jenë njohur me të katër rezultatet e provimeve të tyre. Në faqen e internetit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me adresë [www.mash.gov.al](http://www.mash.gov.al), duke klikuar në butonin **Matura Shtetërore**, do të gjeni:

- A - listën e programeve të studimit për çdo fakultet të 11 IALP-ve të vendit,
- B - kuotat e miratuara me VKM për çdo program studimi të të gjitha IALP-ve
- C - koeficientët e shkollës (KSH) për çdo program studimi,
- D - koeficientët e lëndëve me zgjedhje (KZ1, KZ2),

E - formulën e llogaritjes së pikëve të shprehur në një tabelë të thjeshtë në Excel. Duke vendosur notat dhe koeficientët, secili maturant mund të llogarisë pikët për secilën prej preferencave. Pikët shfaqen automatikisht në qelizën PIKËT.

F – Pikët e fituesit të fundit për çdo program studimi në katër vitet e fundit (2007-2010)

Në këtë mënyrë, pasi njihet me listën e programeve të studimit, secili maturant mund të bëjë një listë edhe me më shumë se 10 programe studimi, ku dëshiron të studjojë, në cilindo Universitet të Shqipërisë.

Më pas mund të llogarisë pikët për secilin prej programeve të studimit të listës që ka hartuar. Pas kësaj maturanti duhet të krahasojë pikët e fituara prej tij me pikët e fituesit të fundit në secilin prej programeve të studimit të listës së hartuar prej tij. Kështu secili mund të gjykojë se në cilin prej programeve të studimit ka shanse të fitojë. Kuptohet që në renditje, vendet e para do t'i zenë programet e studimit më të preferuara prej maturantit edhe nëse janë më të vështira për t'u fituar. Më konkretisht, nëse vendosni si preferencë të parë një program studimi në të cilin jeni të sigurtë që fitoni, por nuk ju pëlqen shumë, mund të ndodhë që prej sistemit informatik të shpallen fitues në këtë preferencë edhe pse në preferencat e vendosura më poshtë keni grumbulluar pikët e mjaftueshme për t'u shpallur fitues. Pra, konsultimi me tabelën e pikëve të fituesve të fundit, është element shumë i rëndësishëm ndihmës para plotësimit të Formularit A2.

Vetëm pasi të keni kryer veprimet e mësipërme, mund të rendisni 10 preferencat përfundimtare dhe të plotësoni me kujdes Formularin A2.

## PLOTËSIMI I FORMULARIT A2

### KUJDES NË PLOTËSIMIN ME SHKRIM TË QARTË TË TIJ, SI DHE ME STILOLAPS ME BOJË TË ZEZË, SEPSE FORMULARI LEXOHEM ME SKANIM.

#### I. TË PËRGJITHSHME

1. Për të fituar të drejtën e pranimit në Universitetet e Shqipërisë (IALP), çdo maturant që kërkon të vazhdojë studimet e larta, duhet të plotësojë Formularin A2, origjinal.
2. Formulari A2 është i personalizuar për secilin maturant, sipas të dhënave që ai ka plotësuar në Formularin A1.
3. Për të marrë Formularin A2, maturanti duhet të ketë kryer pagesën prej 2000 lekësh në një bankë të nivelit të dytë dhe të paraqesë faturën e pagesës së kryer.
4. Formulari A2, do të shpërndahet në shkollën ku ka plotësuar formularin A1.
5. **Para se Formulari A2 t'i jepet maturantit, mësuesi kujdestar duhet të plotësojë me përgjegjësi dhe pa korigjime NOTËN MESATARE.** (shih shpjegimet më poshtë, **Pika 2**).
6. Formulari A2 do t'i jepet maturantit nga mësuesi kujdestar, kundrejt dorëzimit të faturës së pagesës së kryer.
7. Formulari A2, në pjesën e prapme përmban disa udhëzime të rëndësishme. Në fund të saj janë zonat që do të plotësohen dhe firmosen nga nxënësi, mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës, pasi të kenë shkruar emër dhe mbiemër. Çdo formular vuloset me vulën e shkollës. Mësuesi kujdestar dhe Drejtori i shkollës mbajnë përgjegjësi për formularët e shpërndarë pasi janë kopje unike DHE NUK RIPRODHohen.
8. Për evidentimin e marrjes në shkollë të Formularit A2 nga maturanti dhe dorëzimin e plotësuar me preferencat tek mësuesi kujdestar, do të shërbejë një pasqyrë tip që shoqëron Formularin A2 (shpjegimet më poshtë në **Pikën 6**).
9. Ky formular, **mund dhe duhet** të fotokopjohet nga nxënësit, për t'u ushtruar në plotësimin e saktë të tij, por në shkollë **do të dorëzohet Formulari A2 origjinal i plotësuar**, pasi fotokopja është e pavlefshme.
10. **Maturantë: Kujdes në plotësimin e saktë të Formularit A2. Studjojeni, konsultohuni, provoni në fotokopje dhe vetëm pasi të jeni të bindur, plotësoni origjinalin. Ju do të**

shpalleni fitues vetëm në një program studimi dhe programin e studimit tuaj të preferuar e përcaktoni me plotësimin e saktë të Formularit A2.

## II. SHPJEGIME PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT A2

### 1. ELEMENTË PERSONALIZUES TË FORMULARIT A2

Formulari A2 prodhohet i personalizuar, si kopje e vetme, për secilin maturant kandidat të Republikës që ka plotësuar Formularin A1 si dhe kërkesën për provimet me zgjedhje. Të dhënat për maturantin kandidat merren nga Formularit A1.

Në krye të Formularit A2, poshtë kokës së tij paraqiten:

Rrethi, qyteti ose fshati, emri i shkollës, emri, atësia, mbiemri dhe datëlindja e maturantit kandidat dhe në të djathtë ID e tij.

Pra siç kuptohet askush nuk mund të marrë një Formular A2, që nuk i përket atij.

### 2. NOTA MESATARE :

#### (E plotëson vetëm MËSUESI KUJDESTAR)

- Poshtë emrit të maturantit është vendosur **Nota Mesatare** e cila duhet plotësuar me shifra dhe me fjalë. Me kujdes dhe përgjegjësi mësuesi plotëson kutitë me shifra arabe. Shifrat duhet të jenë të qarta, pa korigjime dhe të shkruara me stilolaps me ngjyrë të zezë. Vetëm në rastin e notës **10.00** mbushen të katër kutitë. Në

Plotesoni Notën Mesatare me numra dhe me fjale

6	5	3
GJASHTE . PESEDHJETE E TRE		

Plotesoni Notën Mesatare me numra dhe me fjale

7	0	0
SHTATE . ZERO ZERO		

- të gjitha rastet e tjera, nota fillon në kutinë e dytë. P.sh. **6.53** : Shifra **6** shkruhet në kutinë e dytë, kutija e parë mbetet bosh dhe pas pikës shkruhen shifrat **5** dhe **3** në kutitë pasardhëse. Dy kutitë e pjesës dhjetore mbushen detyrimisht, p.sh. nëse nota mesatare është **7**, do të shkruhet **7.00**; nëse nota mesatare është **8.2**, do të shkruhet **8.20**.
- Pasi plotësohen kutitë me shifra, më poshtë, në kutinë para pikës, shkruhet me fjalë pjesa e plotë e notës së mësipërme si p.sh.: dhjetë, shtatë, tetë. Shkrimi duhet të jetë i qartë, i lexueshëm dhe me gërma **kapitale**.
- **Kujdes!** Nota mesatare është mesatarja e notave të katër ose pesë viteve të studimit. Është ajo notë që do të vendoset në Diplomën e Maturës Shtetërore për maturantët e këtij viti shkollor. Për nxënësit që kanë mbaruar vitet e kaluara shkollore (2006 – 2010), do të merret nota mesatare e shënuar në Dëftesën e Pjekurisë si notë mesatare e katër ose pesë viteve të studimit. Në këtë përlllogaritje **nuk do të merren parasysh** notat e provimeve të maturës. Në shkolla, janë dëftesat origjinale për ata që kanë plotësuar Formularin A1, të cilat do të shërbejnë për evidentimin e notës mesatare nga mësuesit kujdestarë.
- Maturanti kandidat duhet të vihet në dijeni për notën mesatare, që do të vendoset në Formularin A2 të tij.

## PROGRAMET E STUDIMIT NË UNIVERSITETET E VENDIT

### 3. LISTA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT

- Lista e programeve të studimit zë pjesën më të madhe të Formularit A2. Maturantët kandidatë duhet ta lexojnë me shumë kujdes këtë listë, për të përcaktuar programet e studimit që preferojnë të ndjekin. Për secilin Universitet të Shqipërisë janë renditur të gjitha programet e studimit. Përpara secilit prej programeve të studimit, ka një numur me 3 shifra, që përfaqëson atë program studimi si dhe një kuti bosh.

- Duke ndjekur me kujdes listën e programeve të studimit, së pari përqëndrohuni në Universitetin ku dëshironi të ndiqni studimet.
- Lexoni me kujdes programet e studimit të atij Universiteti dhe për një program studimi që preferoni, mbani shënim numrin e programit të studimit dhe emërtimin e tij, p.sh në Universitetin e Tiranës: **011 Kimi Ushqimore**. Po brenda të njëjtit Universitet mbani shënim numrin dhe emërtimin e programeve të studimeve të tjera të preferuara, p.sh. **026 Punë Sociale**, e kështu me radhë. Mund të mbani shënim numrin dhe emërtimin e programeve të studimit që preferoni në cilindo Universitet Publik, p.sh. në Universitetin Politeknik të Tiranës **069 Inxhinieri Mjedis**, e kështu me radhë preferencat e tjera.
- Këto informacione janë të nevojshëm dhe të dhëna si shembull për të gjithë ata kandidatë maturantë që preferojnë këto programe studimi. Natyrisht secili maturant do të vendosë preferencat e tija në Formularin A2.
- Për zgjedhjen e programeve të studimit, janë dhënë udhëzime në Këshillimin e Karrierës, janë shkruar artikuj në Revistën “Mësuesi”, si dhe është publikuar në faqen e internetit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës i gjithë informacioni i nevojshëm. Përpiquni të masni forcat tuaja dhe të zgjidhni programe studimi ku keni probabilitet të të fitoni duke konsultuar sëpari pikët tuaja me pikët e fituesit të fundit për secilin program studimi të viteve paraardhëse të publikuara në faqen zyrtare të internetit të MASH.
- Në plotësimin e Formularit A2, keni të drejtë të plotësoni deri në 10 programe studimi të preferuara. Me zgjedhjet e mësipërme mund të krijoni një listë me 10 ose më shumë programe studimi, që në fund të fundit do të reduktohen në jo më shumë se 10 programe studimi.

Vendosni numrin e preferencës në kraht të

UNIVERSITETI I TIRANËS	
<input type="checkbox"/>	001 Histori
<input type="checkbox"/>	002 Gjeografi
<input type="checkbox"/>	003 Gjuhë - Letërsi
<input type="checkbox"/>	004 Gazetari
<input type="checkbox"/>	005 Biologji
<input type="checkbox"/>	006 Bioteknologji
<input type="checkbox"/>	007 Matematikë
<input type="checkbox"/>	008 Fizikë
<input type="checkbox"/>	009 Informatikë
<input type="checkbox"/>	010 Kimi
<input type="checkbox"/>	011 Kimi Ushqimore
<input type="checkbox"/>	012 Kimi Industriale

#### 4. PREFERENCAT

- Para se të plotësoni preferencat, konsultohuni me familjen, diskutoni me të afërmit dhe nga lista që formuat me shënimet që mbajtet më sipër, **formoni një listë ku programet e studimit i rendisni sipas preferencave**. E para do të jetë dega që preferoni më shumë ose ajo për të cilën keni marrë pjesë në konkurs, e dyta ajo që preferoni sipas rradhës nëse nuk do të fitoni në Preferencën e parë e kështu me radhë. **Preferenca më e lartë është Preferenca 1**. Kjo për arsye se mbi bazën e preferencave do të shpallen fituesit për secilin program studimi. Kontrollohet Preferenca 1, nëse aty jeni fitues, aty shpallen për regjistrim në Universitetin përkatës. Nëse nuk jeni fitues në Preferencën 1, kontrollohet Preferenca 2 e kështu me radhë deri në Preferencën 10. Shpallen fitues në Preferencën më të lartë ku keni grumbulluar pikët e nevojshme. **Fitues jeni vetëm në një program studimi, në atë të preferencës më të lartë** në grupin e preferencave ku keni grumbulluar pikët e mjaftueshme. E thënë me fjalë të tjera edhe sikur të keni pikët e mjaftueshme dhe renditje të kënaqshme për preferenca të tjera të cilat i keni renditur më poshtë, fitues do të shpallen në preferencës që është më lart të tjerave, në të cilat plotësoni pikët e mjaftueshme.
- Procesi i llogaritjeve është plotësisht transparent. Për çdo program studimi do të shpallet lista e kandidatëve të renditur sipas pikëve të fituara. Në këtë listë evidentohen dhe fituesit. Një kandidat, në listën e një dege, mund ta shohë veten në fillimet e listës, por nuk është fitues në këtë program studimi. Kjo për arsye se ky program studimi është preferencë e ulët e tij, p.sh. e pesta. Ai e sheh veten fitues në preferencën e tij më të lartë, p.sh. në Preferencën 2.

- Pasi të keni vendosur renditjen e programeve të studimit sipas preferencave, nga 1 në 10, vetëm atëherë mund të jeni gati për të plotësuar preferencat dhe renditjen e tyre tek Formulari A2.

## 5. PLOTËSIMI PREFERENCAVE

- Në të djathtë lart tek Formulari A2, ndodhen 10 kuadrate me numrat rendorë përkatës nga 1 deri në 10. Këta numra rendorë përfaqësojnë numrin e preferencës. Gjatë plotësimit të këtyre kuadrateve duhet shumë kujdes.
- Për plotësimin e secilës preferencë janë në dispozicion 3 (tre) kuti. Në çdo kuti shënohet një shifër e qartë dhe pa korigjime. Numri i formuar, përfaqëson numrin e programit të studimit që keni zgjedhur për atë preferencë. P.sh. në kutinë me Nr. **1** është shkruar shifra **013**. Kjo do të thotë që programi i studimit i kandidatit me preferencë të parë (më të lartën) është Inxhinieri Matematike dhe Informatike në Universitetin e Tiranës.
- Pasi plotësohen kutitë e të dhjetë preferencave me shifra, do të plotësojmë kutitë para emërtimeve të programeve të studimit me shifrën e renditjes përkatëse të preferencës. Shifra duhet të jetë e shkruar qartë, me stilolaps me ngjyrë të zezë.

- Nëse në preferencën **1** (në krahtë të djathtë të Nr. 1) kemi shkruar **013**, atëherë do të do të zhvendosemi poshtë në listën e programeve të studimit dhe gjejmë programin e studimit me numër **013**. Në kutizën para këtij programi studimi, do të shënojmë numrin **1**. Pra në listën e programeve të studimit, numri në kutinë përpara tregon renditjen e preferencës dhe në numrat e preferencave në pjesën e sipërme të formularit tregohet numri i programit të studimit. **Kujdes! Përputhja duhet të jetë e plotë.**

Plotësoni KODIN e Programit të Studimit për secilën Preferencë						
1	0	1	3	6		
2	0	0	3	7		
3	0	0	1	8		
4				9		
5				10		

- Në listën e programeve të studimit në pjesën e poshtme të formularit, nuk mund të ketë më shumë se dhjetë kuti të plotësuar me shifrat nga 1 deri në 10. Kuptohet që të gjithë kutitë e tjera do të jenë bosh.
- Vazhdojmë me preferencat e tjera. Në figurë jepet shembulli i mbushjes së preferencave 1, 2 dhe 3, që janë përkatësisht **013** –Inxhinieri Matematike dhe Informatike në Universitetin e Tiranës; **003** –Gjuhë Letërsi në Universitetin e Tiranës, **001** –Histori në Universitetin e Tiranës, e kështu me radhë mbushen të dhjetë preferencat.
- Ja si do të jenë të plotësuar kutitë para programeve të studimit përkatës (Figura djathtas).
- Është e detyrueshme që të mbushen të 10 kutitë e Preferencave, ndryshe Formulari quhet i pavlefshëm.
- Në rastet kur keni zgjedhur më pak se 10 programe studimi të preferuara, kutitë e tjera të Preferencave mbushen **detyrimisht** me shifrën **000**. **Rekomandojmë të mos humbni mundësitë, zgjidhni dhjetë programe studimi.**

Vendosni numrin e preferencës në krahtë	
<b>UNIVERSITETI I TIRANËS</b>	
<input type="checkbox"/>	001 Histori
<input type="checkbox"/>	002 Gjeografi
<input checked="" type="checkbox"/>	003 Gjuhë - Letërsi
<input type="checkbox"/>	004 Gazetari
<input type="checkbox"/>	005 Biologji
<input type="checkbox"/>	006 Bioteknologji
<input type="checkbox"/>	007 Matematikë
<input type="checkbox"/>	008 Fizikë
<input type="checkbox"/>	009 Informatikë
<input type="checkbox"/>	010 Kimi
<input type="checkbox"/>	011 Kimi Ushqimore
<input type="checkbox"/>	012 Kimi Industriale
<input checked="" type="checkbox"/>	013 Inxhinieri Matematike dhe Informatike
<input type="checkbox"/>	014 Teknologji informacioni dhe komunikimi
<input type="checkbox"/>	015 Gjuhë Angleze

## 6. DORËZIMI I FORMULARIT A2

- Në momentin që maturantit kandidat i dorëzohet Formulari A2 nga mësuesi kujdestar, maturanti dorëzon mandat pagesën dhe të dy këta firmosin në pasqyrën tip të shpërndarë në shkolla nga DAR/ZA-të përkatëse. Gjithashtu marrja në dorëzim e Formularit A2 të plotësuar me preferencat e maturantit kandidat bëhet nga mësuesi kujdestar duke firmosur ai dhe maturanti sërish në pasqyrën tip.
- Pasqyra tip origjinale, e plotësuar në këtë mënyrë, dorëzohet sëbashku me Formularët A2 të plotësuar dhe të shoqëruar me mandat pagesat përkatëse, fillimisht në DAR/ZA, të cilat më pas i përcjellin zyrtarisht në Agjencinë Kombëtare të Provimeve (AKP). Fotokopja e pasqyrës ruhet në shkollë.
- Maturantëve kandidatë u rekomandohet që ta fotokopjojnë Formularin A2 të plotësuar nga ana e tyre dhe ta ruajnë për çdo kërkesë që mund t'i dalë në të ardhmen.

**Në përfundim për të shmangur gabimet në plotësimin e formularit A2, nisur dhe nga përvojat e mëparshme, ju japim maturantëve kandidatë disa këshilla shumë të rëndësishme.**

1. Kujdesuni të mbani mend saktë ID-në tuaj personale sepse është pasaporta juaj e konkurrimit.
2. Plotësoni personalisht Formularin A2 në mënyrë që t'i kontrolloni vetë degët e vendosura. Mos e lini në dorë të personave të tjerë, mësuesit, prindërit apo të njohurit kanë të drejtë vetëm t'ju këshillojnë.
3. Përpara se të plotësoni formularin shihni në Web Site e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) koeficientët e shkollës dhe të lëndëve me zgjedhje për programet e studimit që do të preferoni. Maturantët kandidatë që kanë mbaruar një shkollë të mesme në profilin shoqëror kanë më pak shanse të shpallen fitues në programet e studimit me profil natyror.
4. Nuk sugjerohet plotësimi i më pak se 10 preferencave në formularin A2, sepse zvogloni shanset tuaja për të fituar një të drejtë studimi. **Kujdes! Këshillojmë që të plotësohen të 10 preferencat në mënyrë që të rrisni shanset tuaja të suksesit.**
5. Kur të plotësoni formularin A2 nuk ka nevojë të përsëritet disa herë e njëjta preferencë, sepse nuk jep asnjë ndikim pozitiv në qënien fitues apo jo në këtë program studimi. Kjo do të thotë që preferenca juaj merret vetëm njëherë në konsideratë nga sistemi informatik.
6. Shifrat që përbëjnë numri e ID-së së degës dhe që plotësohen në pjesën e sipërme djathtas të formularit A2 duhet të jenë qartësisht të lexueshme sepse mund të bëhen ngatërresa. Është e këshillueshme që plotësimi të mos bëhet menjëherë në formularin origjinal, por të bëhen prova në fotokopje të tij derisa të jeni të bindur për zgjedhjet që keni bërë.
7. Preferencat e para duhet të plotësohen me degët më të dëshiruara dhe pastaj të tjerat me radhë në bazë të dëshirës, sepse nëse vendosni një degë që nuk është shumë e preferuar në preferencat 1,2,3 dhe fitoni në këto degë nuk keni shanse në degët tuaja të preferuara që renditen më poshtë.
8. Gjatë plotësimit të A2 kujdesuni që shënimet (shifrat) në pjesën e poshtme të formularit të përputhen me pjesën lart . Duhet të keni të qartë që informacioni në pjesën lart - djathtas është ai që lexohet nga operatorët gjatë hedhjes së të dhënave në kompjuter. Me shënimet e bëra në pjesën e poshtme operatori konsultohet kur ka dyshim në shifrat e shkruara në mënyrë të pakuptueshme në pjesën e sipërme.
9. Maturantët të cilët konkurojnë në programe studimi që përveç provimeve të maturës zhvillojnë edhe konkurs pranë fakulteteve si psh. Arkitekturë , Arte, Sporte, Pedagogji e specializuar, nëse këto programe studimi për ta janë ato që dëshirojnë më shumë, duhet të bëjnë kujdes që këto programe studimi t'i rradhisin në krye të listës së preferencave të plotësuar në Formularin A2. Vëmë në dukje se në vitet e kaluara ka ndodhur që ndonjë maturant i cili ka konkuruar për këto programe studimi nuk i ka vënë si preferencë të parë. Për rrjedhojë ai duke i ka kapur pikët e mjaftueshme në degë të tjera të vendosura më lart në

- renditjen e preferencave, sistemi informatik e ka shpallur fitues në degën me preferencë më të lartë, pavarësisht se në konkursin përkatës ka dalë me rezultate të mira.
10. Lexoni me vëmendje programet e studimit që do të zgjidhni në formular, duke bërë shumë kujdes në leximin e vëmendshëm edhe të tekstit të shkruar në kllapa. Atje përcaktohet filiali i Universitetit dhe në disa raste kohëzgjatja e studimeve. Ka ndodhur më parë që maturantët kandidatë të kenë përzgjedhur programe studimi të Universitetit të Tiranës apo të Durrësit, pa vënë re që ky program zhvillohet në filialet e këtyre Universiteteve në Kukës, Peshkopi apo gjetkë. Gjithashtu kujdes duhet bërë edhe në leximin e vëmendshëm të kohëzgjatjes së programit të studimit, sepse ka të tilla që e përfundojnë ciklin e studimeve për dy ose tre vjet.
  11. Kandidatët që mbartin nota nga vitet paraardhëse duhet të plotësojnë me kujdes formularin e mbartjes së notave. Nëse nuk i kanë të gjitha notat të pasqyruara në bazën e të dhënave ata nuk do të përfshihen në konkurim.
  12. Kujdes! Kontrolloni që në Formularin A2 të jetë plotësuar saktë mesatarja nga mësuesi kujdestar.
  13. Kontrolloni me kujdes librin e transparencës dhe verifikoni të gjitha të dhënat tuaja të mëposhtme dhe, nëse rezultojnë pasaktësi, plotësoni formularin e korigjimit të pasaktësive të cilin do e merrni dhe më pas duhet ta dorëzoni në shkollën tuaj.
    - Emër, Atësi, Mbiemër
    - Datëlindja
    - Indeksi i profilit
    - Notat D1, D2, Z1, Z2 ,Mesatarja e shkollës së mesme
  14. Ndiqini hap pas hapi dhe me vëmendje maksimale njoftimet zyrtare në Website e MASH, nëpër shkolla dhe DAR/ZA për datat e kryerjes së regjistrimeve në të gjitha fazat e shpalljes së fituesve në Universitetet Publike (IALP). **Kujdes! Një maturant kandidat që është shpallur fitues në një program studimi në fazën e parë të shpalljes së fituesve dhe është regjistruar, në fazat e mëtejshme mund të shpallet fitues në preferenca më të larta të përzgjedhura nga ai. Në këtë rast ai duhet të çrregjistrohet nga programi i mëparshëm i studimit dhe të rregjistrohet në programin e ri fitues të preferencës më të lartë. Nëse nuk e bën këtë veprim humbet të drejtën e vazhdimit të studimeve në IALP.**
  15. Llogaritni pikët tuaja sipas formulës së shfaqur në Websiten e MASH për secilin program studimi në veçanti, sepse për programe të ndryshme studimi në varësi të koeficientëve, ju grumbulloni sasi të ndryshme pikësh.

The screenshot shows an Excel spreadsheet with the following data in the first few rows:

D5	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S	T	U	V	W
1																							
2	D1	KD1	D2	KD2	MES	KSH	Z1	KZ1	Z2	KZ2	%MAT	PKNX	PKMAX	%KONK	KONK	ND							
3	5.16	0.20	8.22	0.20	5.54	1.40	7.84	1.30	7.05	1.30	20.00	65.00	240.00	80.00	-	1							
4																							
5	PIKET		4584.5																				

The spreadsheet also contains a list of definitions for the variables used in the formula, such as D1, D2, Z1, KZ1, Z2, KZ2, %MAT, PKNX, PKMAX, %KONK, KONK, and ND.